VENDIM
Nr.269 , datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.53, DATË 29.1.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE FLUTURUES NË PENSION"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 8, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr.53, datë 29.1.2004, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Personi i interesuar, për efekt të llogaritjes, caktimit dhe pagesës së shtesës mbi pension, si trajtim i veçantë financiar, në zbatim të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension", paraqet kërkesë nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*".".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj